



**KOPSHTI PARASHKOLLOR “ZOGJTË”**  
**SHPALL**  
**KONKURS PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE**

Nr	Grup-mosha	Numri i fëmijëve
1.	0.9 muaj - 2 vjeç	15 fëmijë
2.	2-3 vjeç	15 fëmijë
3.	3-4 vjeç	15 fëmijë
4.	4-5 vjeç	15 fëmijë
5.	5-6 vjeç	10 fëmijë

Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:

1. Ekstrakti i lindjes së fëmijës;
2. Dëshmi që jeni banorë të lagjes Sofalia (vërtetimi nga Bashkësia Lokale; faturë të shërbimeve, dëshmi apo kontratë të pronës/vendbanimit etj)
3. Dokumentet tjera valide të lëshuara nga institucionet relevante për të dëshmuar kategoritë tjera.

Çmimi i çerdhes është 100 euro në muaj.

Por në bazë të të ardhurave mujore që marrin të dy prindërit, Komuna e Prishtinës do të subvencionon një pjesë të pagesës:

1. Prindërit me të ardhura mujore deri në 500 euro, Komuna i subvencionon me vlerë 50 euro në muaj për fëmijë.
2. Prindërit me të ardhura mujore deri në 700 euro, Komuna i subvencionon me vlerë 30 euro në muaj për fëmijë.
3. Prindërit me të ardhura mujore deri në 1000 euro, Komuna i subvencionon me vlerë 20 euro në muaj për fëmijë.
4. Prindërit me të ardhura mujore mbi 1000 euro nuk do subvencionohen nga Komuna dhe paguajnë pagesën e plotë

Pranimi i dokumenteve bëhet prej datës 3 shkurt deri më 10 shkurt 2017. Dokumentet pranohen çdo ditë pune nga ora 09:00 -15:00.

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në objektin e çerdhes “Zogjtë” në lagjen Sofalia afër SHMU “7 Shtatori”.

Prindërit të cilët do të kërkojnë subvencionimin e pagesës do të kërkojnë të sjellin dokumente shtesë për të vërtetuar gjendjen ekonomike dhe të ardhurat mujore.

Të gjithë të pakënaqurit me rezultatet e regjistrimit mund të ushtrojnë ankesë në kopshtin “Zogjtë”, Sofali, Prishtinë.

Vërejtje: Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë që dorëzohen do të verifikohen nga institucionet përkatëse dhe nëse ka dyshime mbi vërtetësinë e dokumentacionit apo dëshmive do të humbni të drejtën për subvencionim të pagesës.